



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 23 Korrik 2021

Nr: 106

VENDIM

PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 62, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN
23.07.2021 PËR PLOTËSIMIN E ELEMENTEVE TË FORMËS, TË PËRCAKTUARA NË
NENIN 126 TË KODIT ZGJEDHOR

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 62 të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit datë 22.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, 124, 124/1 126, 129 dhe 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë,

V Ë R E N:

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 62 regj, datë 23.07.2021.

Në mbledhjen e datës 23.07.2021, ora 16:30, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 62 nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi nuk referohet vendimi që ankimohet ashtu siç parashikon neni 126, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të K. Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij kodi.

Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 126, të K. Zgjedhor, kjo kërkesë duhet të kthehet për plotësimin e elementeve të formës, të përcaktuara si më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 129 pika 1 dhe pika 3 shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 2, dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,



V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 62, datë 23.07.2021, për plotësimin e elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të K. Zgjedhor të paraqitur nga subjekti Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

